



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 50, datë 06.07.2016

Për

**“MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA TË OBJEKTIT “TRUALL ” ME SIPËRFAQE
TOTALE 10.458.81 M² NË RRUGËN “HAMDI PEPA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 6**

Bashkia e Tiranës, mbështetur në ligjin nr. 115/2014, për “Ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore”, ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtëshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014, për “Përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar) kërkesës të subjektit për marrje me qira të objektit “Truall”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të dhënies me qira të objektit “truall” me sipërfaqe totale 10.458.81 m² në rrugën “Hamdi Pepa”, për një afat prej 20 vjetësh.
2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij në mbështetje të VKM- në nr.54, datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”
3. T’i dërgohet dosja me propozimet përkatëse Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si përfaqësues i pronarit të pronës publike, kryerja e procedurave të mëtejshme për lidhjen e kontratës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI